



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 02 Korrik 2021

Nr: 422

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. QERIM ISMAIL
ISMAILAJ, KRYETAR I BASHKISË MALLAKASTËR, QARKU FIER, NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Sot më datë 02.07.2021, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike, shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, qarku Fier, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

Palë të interesuara: 1. Kryetari i Bashkisë Mallakastër, z. Qerim Ismail Ismailaj, përfaqësuar me prokurë të posacme nr. Repertori. 5812, Nr. Koleksioni. 1781 datë 30.06.2021, nga avokat z. Besnik Strati përfaqësues me prokurë.
2. Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga z. Ivi Kaso

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 2 dhe 4, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të Kreut V, pikat 5 dhe 12 të vendimit nr.

17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe pasi dëgjova pretendimet përfundimtare të palëve:

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kryetari i Bashkisë”.

Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër Unik 2456 datë 12.05.2019.

Në bazë të kompetencave të veta, KQZ bën verifikimin prima facie dhe në kuadër të këtij lloji verifikimi, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. me shkresën nr. 3107 prot., datë 12.05.2019 kërkoi informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve, e cila me shkresën nr. 1487/1 prot., datë 14.05.2019, informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për kryetar bashkie, z. Qerim Ismail Ismailaj, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar.
- b. me shkresën nr. 3086 prot., datë 13.05.2019, kërkoi informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila deri në momentin e regjistrimit të këtij subjekti si kandidat për kryetar i Bashkisë Mallakastër, nuk ktheu përgjigje.

Pas përfundimit të verifikimit “prima facie”, duke konstatuar se subjekti z. Qerim Ismail Ismailaj, nuk ka pasqyruar ndonjë të dhënë për sa i përket gjendjes gjyqësore të tij, apo ndryshime të gjenealiteteve të mëparshme, si dhe nuk ka dënime penale të formës së prerë në ngarkim të tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 438, datë 16.05.2019, regjistroi si kandidat për kryetar të Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, z. Qerim Ismail Ismailaj.

Në përfundim të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1097, datë 27.07.2019 miratoi “Shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019”, sipas të cilit z. Qerim Ismail Ismailaj, u shpall fitues në funksionin e kryetarit të Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier.

Pranë Prokurorisë së Përgjithshme, më datë 09.01.2020, është paraqitur kërkesë nga subjekti politik “Partia Demokratike”, me objekt “Verifikimi i pastërisë së figurës së shtetasit Qerim Ismaili”, në zbatim të përcaktimeve të pikës 2 të nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Me shkresën nr.27/1 prot., datë 13.01.2020, Prokuroria e Përgjithshme i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të paraqesë pranë kësaj prokurorie formularin e vetëdeklarimit të subjektit Qerim Ismailaj, si dhe çdo verifikim tjetër të kryer ndaj tij.

Me shkresën nr.38/1 prot., datë 25.01.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve paraqiti pranë Prokurorisë së Përgjithshme formularin e vetëdeklarimit të këtij subjekti si dhe gjithë materialin e kërkuar që dispononte, gjatë verifikimit “prima facie” të subjektit Qerim Ismailaj.

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 27/59 ex prot., datë 14.06.2021, të administruar nga KQZ-ja me nr. 5775 prot., datë 15.06.2021, ka dërguar vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj.

Sipas dipozitivit të këtij vendimi konstatohet se z. Qerim Ismail Ismailaj:

- Nuk rezulton të ketë gjenealitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
- Rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale, nga autoritet gjyqësor i huajReferuar Vendimit nr.9-11/2000 të Gjykatës së përbërë nën betim të Kios, i formës së prerë rezulton se i akuzuari Qerim Ismailaj (në mungesë në gjykim), është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 3 (tre) vjet burgim, për veprën penale të “Konfliktit/Përleshjes” parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal të Republikës së Greqisë, që i korespondon veprës penale të “dëmtimeve të tjera me dashje”parashikuar nga neni 90/1 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, e cila si sanksion parashikon dënim vetëm me gjobë.
- Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të jetë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;

- Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese të huaja apo shqiptare për kryerjen e një vepre penale; Nuk rezulton të ketë qenë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale nga një autoritet shqiptar apo i huaj; Nuk rezulton i dëbuar/deportuar nga një autoritet i huaj.”

II.

Pretendimet e palëve në proces:

Referuar neneve 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thirri si palë të interesuara në këtë shqyrtim administrativ, z. Qerim Ismail Ismailaj, dhe Partinë Demokratike.

Përfaqësuesi me prokurë i z. Ismailaj, avokat z. Besnik Strati, pasi argumentoi dhe paraqiti provat për çështjen, në përfundim të pretendimeve të tij kërkoi:

“...Të vlerësohen në tërësi materialet e vendosura në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe provat shtesë nga subjekti që provojnë të kundërtën e pretendimit të kërkuesit dhe të mbahet një qëndrim objektiv ndaj këtij qëndrimi dhe qëllimi i vlerësimit të drejtë të pozitës së subjektit. Kërkojmë nga ana juaj vijimin e ushtrimit të funksionit të detyrës së subjektit vetëdeklarues. Bashkangjitur po ju sjell dhe provat, të cilat i kemi në formën e kërkuar nga ligji. Një dëshmi penaliteti nga shteti grek ku vërtetohet se është i padënuar. Vërtetimin e sigurimeve shoqërore 1999-2000, ka qenë i punësuar në listën e pagesave si dhe një kopje të pasaportës nga sistemi TIMS.”

Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, z. Ivi Kaso deklaroi: “Ajo çfarë ne parashtruar dhe i qëndrojmë është që interpretimi që Prokuroria e Përgjithshme bën në shkresë në lidhje me konvertimin e veprës, ka vend vetëm në ndalimet e parashikuara nga shkronja “a” dhe shkronja “b”, të cilët bëjnë fjalë për veprat e kategorisë dhe ndalimet sipas veprave penale dhe është logjike që një krim ose vepër e kryer në një shtet të huaj, sigurisht që do të shihet, nëqoftëse përkthehet në kategorinë e veprave në shkronjat “a” dhe “b” ndalojnë. Shkronja “ç” dhe shkronja “c” nuk kanë të bëjnë me llojin e veprës dhe prandaj dhe operacioni që prokuroria ka kryer në shkresën që i kthen përgjigje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i pavlerë në këndvështrimin tonë për efekt të këtij shqyrtimi, pasi ndalimi ka të bëjë me çfarëdolloj vepre që të jetë kryer në shtetin e huaj, mjafton që të jetë dënuar me më shumë se 2 (dy) vjet burg, në rastin e shkronjës “c” dhe me shumë se 6 (gjashtë) muaj burg në rastin e shkronjës “ç”. Për këtë arsye ne vlerësojmë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri në këtë rast, në zgjidhjen e kësaj çështjeje, nuk duhet të mbajë parasysh atë pjesë të interpretimit që Prokuroria e Përgjithshme ka bërë dhe zgjidhjes së drejtë të kësaj çështjeje.”

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson si vijon:

1. Rezulton e provuar se subjekti z. Qerim Ismail Ismailaj, është dënuar me vendim të formës së prerë me 3 (tre) vjet burg, nga një gjykatë e shtetit grek. Për veprën penale “Konflikt”, të parashikuar nga nenin 313 i Kodit Penal të Republikës së Greqisë.
2. Prokuroria e Përgjithshme, ka përcaktuar se vepra penale “Konflikt” parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal Grek ka “korrespondente” të saj në të Kodin Penal shqiptar veprën penale “të dëmtimeve të tjera me dashje” parshikuar nga nenin 90/1, i cili e konsideron këtë vepër si kundërvajtje penale dhe sanksionon dënim vetem me gjobë.
3. Në lidhje me ashpërsinë e sanksionit penal të vendosur nga gjykata e Chios, lind i nevojshëm aplikimi i testit të proporcionalitetit. Referuar standardeve ndërkombëtare për këtë çështje, theksohet se ashpërsia e dënimit (sanksionit penal) nuk duhet të aplikohet automatikisht¹. Kjo për arsye se ashpërsia e dënimit përdoret si një “tregues moral” dhe se kjo duhet të bazohet në standarde të zbatueshme edhe në vendin e dhënies së mandatit/ zgjedhjes së individ në funksione publike.
 - a. Pra nëse një person A dënohet në shtetin B dhe kohëzgjatja e dënimit/ sanksionit penal e ndalon atë të zgjidhet në shtetin C, ai zakonisht nuk duhet të pengohet nga e drejta për t’u zgjedhur në rast se e dënimi/ sanksioni për të njejtën vepër penale nuk do ta ndalonte atë për t’u zgjedhur.
 - b. Me fjalë të tjera, në raste se dënimi për një vepër penale të ngjashme në vendbanimin e të zgjedhurit është më e ulët, kufizimi proporcional për t’u zgjedhur nënkupton marrjen në konsideratë të ashpërsisë së veprës penale dhe jo të sanksionit/ dënimit.
 - c. Referuar këtij testi proporcionaliteti dhe vendimit të arsyetuar të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj është dënuar për një kundërvajtje penale sanksioni i së cilës në Republikën e Shqipërisë, parashikon vetëm gjobë.

¹ Opnioni Nr. 807/2015 “Raport i Komisionit të venecias për largimin nga Kuvendi të shkelësve të ligjit”, par. 160

4. Neni 2 i ligjit 138/2015 referon kriteret e ndalimit dhe moszgjedhshmërisë në dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Në këtë këndvështrim edhe Prokuroria e Përgjithshme si organi kompetent për verifikimin e thelluar brenda dhe jashtë vendit ka argumentuar se “lidhur me caktimin e dënimit ndaj shtetasit shqiptar Qerim Ismailaj, ndodhemi përpara rastit kur pavarësisht se dënimi nga gjykata greke është dhënë me burgim, ai është i pazbatueshëm përse i takon llojit të dënimit (me burg), pasi neni 90/1 i Kodit Penal shqiptar parashikon dënim vetëm me gjobë dhe në këto kushte nuk mund të tejkalohet kufiri maksimal i dënimit për veprën penale që parashikon të njëjtin fakt për të cilin personi është dënuar nga një gjykatë e huaj. Në këtë këndvështrim, dënimi i vetëm që mund të jepet nga gjykata shqiptare në një rast të tillë, është vetëm dënimi me gjobë”.
5. Në lidhje me faktin që subjekti vetdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, në formularin e vetëdeklarimit tij nuk ka plotësuar rubrikën që evidenton një dënim penal, Komisioneri vlerëson se rezulton e provuar nga Prokuroria e Përgjithshme se subjekti vetëdeklarues nuk ka pasur dijeni për vendimin nr. 9-11/2000 të Gjykatës së përbërë nën betim të Chios.
6. Neni 2 i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka përcaktuar në tërësinë e vet rastet e ndalimit të ushtrimit të një funksioni publik:
 - për disa kategori veprash penale, pavarësisht masës së dënimit.
 - për çdo vepër penale tjetër, duke marrë në konsideratë ashpërsinë e sanksionit.

Pra, që KQZ të gjykojë që subjekti deklarues është apo jo në kushtet e nenit 2 pika 1 shkronjat “c” dhe “ç” edhe nëse vepra penale nuk përfshihet në kategorinë e atyre veprave penale për të cilat ai do të ndalohej që të kandidonte pavarësisht masës së dënimit, duhet që të konstatojë nëse subjekti është gjendur fajtor për kryerjen e një krimi sipas Kodit Penal shqiptar dhe është dënuar mbi 6 muaj apo mbi 2 vjet.

7. Në rastin kur vendimet penale apo procedimet penale janë dhënë/kryer nga një autoritet gjyqësor i huaj, Komisioneri nuk ka kompetencën lëndore për të vlerësuar nëse një vepër penale e kryer në një territor të huaj, kualifikohet si një nga ato veprat penale të parashikuara në Kodin Penal shqiptar, për të cilat ai do të ishte në kushtet e ndalimit. Në këtë rast ligji ka parashikuar që organi kompetent për verifikimin e thelluar është Prokuroria e Përgjithshme e cila investohet kryesisht, ose me kërkesë të palëve, dhe organeve që administrojnë formularët e vetëdeklarimit.
8. Është organi i Prokurorisë, i cili i bën interpretimin/vlerësimin e një vendimi/akti të dhënë nga një autoritet procedues penal të huaj dhe “i tregon” KQZ se çfarë vepre penale sipas legjislacionit

V E N D O S:

1. Konstatimin z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.
2. Vazhdimin e mandatit të z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetari Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI



Data: 02 Korrik 2021
Nr. 422

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetar i bashkisë Mallakastër, qarku Fier, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”